

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR
MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR
DECENTRALIZIMIN DHE QEVERISJEN VENDORE, 2023-2030, TË
PLANIT TË SAJ TË VEPRIMIT DHE TË PASAPORTËS SË
TREGUESVE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektakti për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2023-2030 dhe të Planit të Veprimit 2023–2025, si dhe pasaporta e treguesve, propozohet nga Ministri i Brendshëm, si një dokument politik i qeverisë shqiptare me qëllim konsolidimin e mëtejshëm të procesit të decentralizimit për një zhvillim ekonomik vendor të qëndrueshëm me shërbime cilësore, gjithëpërfshirëse për qytetarët dhe transparente drejt standardeve evropiane.

Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2023-2030 dhe Plani i saj i Veprimit, si dhe pasaporta e treguesve (këtu e në vijim SNDQV) është strategjia e dytë pas Reformës Administrative Territoriale (RAT). Reforma Administrative Territoriale u shoqërua me decentralizim të një sërë funksionesh tek qeverisja vendore. Sot më shumë se kurdo, bashkitë kanë një numër të konsiderueshëm kompetencash për t’u shërbyer qytetarëve sipas nevojave dhe në mënyrë demokratike. Këto procese të rëndësishme eliminuan fragmentarizimin e panevojshëm, rritën efikasitetin dhe eficientësinë në ofrimin e shërbimeve dhe përmirësuan dukshëm autonominë fiskale vendore. Kompetencat

janë shoqëruar në mënyrë të vazhdueshme me mbështetje financiare nga ana e Qeverisë Qendrore, e cila e konsideron agjendën e decentralizimit shumë të rëndësishme në procesin e mirëqeverisjes dhe të integritetit evropian.

Gjatë zbatimit të SNDQV-së 2015-2020, vlen të theksohet se rëndësi iu vu procesit të harmonizimit ligjor midis ligjit organik 139/2015 dhe ligjeve sektoriale me qëllim eliminimin e pengesave ligjore dhe institucionale në ekzekutimin e funksioneve nga ana e bashkive. Një analizë e detajuar e bazës ligjore (Matrica e Kompetencave) orientoi Ministrinë e Brendshme për prioritetimin e rekomandimeve/ndryshimeve ligjore të nevojshme me qëllim menaxhimin efikas të funksioneve të deleguara. Kësisoj, një mori vendimesh, udhëzimesh dhe akte të tjera nënligjore u miratuan, çka rriti dukshëm shkallën e harmonizimit ligjor, si një ndër objektivat kryesorë të strategjisë ekzistuese.

SNDQV synon të forcojë dhe të të intensifikoj bashkëpunimin ndërmjet qeverisë vendore dhe asaj qendrore, për të përputhur bazën ligjore (me akte ligjore dhe nënligjore) me funksionet, implementimin e funksioneve të reja dhe vazhdimin e punës për rritje të kapaciteteve të bashkive, shoqëruar me menaxhim më eficient të financave vendore dhe mirëqeverisje, me qëllim nxitjen e zhvillimit ekonomik vendor të qëndrueshëm. E rëndësishme është qasja nga poshtë lart, duke marrë në konsideratë perspektivën e pushtetit vendor në zbatimin e SNDQV në tërësi dhe ushtrimit të funksioneve në veçanti.

SNDQV dhe Plan i Veprimit, si dhe pasaporta e treguesve, është përgatitur në përputhje me frymën e parimeve kushtetuese, Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore dhe ligjeve në fuqi, duke respektuar politikat kombëtare.

SNDQV udhëhiqet nga parime të tilla si parimi i Mirëqeverisjes, të Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore, ato të Hapësirës Administrative Evropiane për qeverisjen vendore, me synim sigurimin e decentralizimit politik, administrativ dhe fiskal.

Ky plan kombëtar veprimi, SNDQV, lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritet 2021–2030, me Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2023-2030, Strategjinë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2022-2030, Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike, Strategjinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021–2027, Strategjinë Kombëtare për Arsimin

2021–2026, Strategjinë ndërsektorale “Agjenda digjitale e Shqipërisë” 2022–2026, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023, Strategjinë Kombëtare për Kulturën 2019- 2025, Strategjia e zhvillimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor në Shqipëri 2020-2025, Strategjia Kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.

SNDQV ka një kohëzgjatje shtatëvjeçare, brenda së cilës synohet konsolidimin e procesit të decentralizimit, krijimin e një mjedisi nxitës për zhvillimin ekonomik vendor të qëndrueshëm, forcimin e të ardhurave vendore të bashkive, digjitalizimin e shërbimeve dhe ofrimin e tyre online, sigurimin e i një qeverisjeje të hapur, rritje të transparencës, llogaridhënies dhe shtrirje më të madhe të e-qeverisjes në nivel vendor dhe avancimin e agjendës së BE-së në nivel vendor, sipas objektivave të synuara.

Në tërësinë e tij SNDQV përbëhet nga gjashtë qëllime strategjike kryesore, të cilat janë në harmoni të plotë me standartet dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian mbi avancimin e mëtejshëm të agjendës së decentralizimit dhe konsolidimit të arritjeve ekzistuese. Kjo strategji mbështetet në fushat e njëjta sikurse strategjia ekzistuese, por duke përmirësuar dhe avancuar masat e secilit objektiv sikurse ushtrimi i funksioneve në mënyrë autonome nga këndvështrimi financiar dhe demokracia vendore e perspektiva evropiane me qëllim arritjen e zhvillimit ekonomik vendor të qëndrueshëm.

Vizioni i SNDQV: “Strategjia synon fuqizimin e njësisve vendore për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm drejt standardeve evropiane. Thënë ndryshe, konsolidimin e procesit të decentralizimit, krijimin e një mjedisi nxitës për zhvillimin ekonomik vendor të qëndrueshëm, forcimin e të ardhurave vendore të bashkive, digjitalizimin e shërbimeve dhe ofrimin e tyre online, sigurimin e i një qeverisjeje të hapur, rritje të transparencës, llogaridhënies dhe shtrirje më të madhe të e-qeverisjes në nivel vendor dhe avancimin e agjendës së BE-së në nivel vendor..” Në mbështetje të vizionit janë formuluar qëllimet kryesore strategjike me objektivat dhe masat përkatëse.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

SNDQV, si një dokument strategjik që parashikon politika për decentralizimin dhe qeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë është tërësisht në harmoni dhe në përputhje me objektivat strategjike të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (*SKZHIE III*) 2021-2030, i cili është dokumenti kryesor strategjik kombëtar që mbështetet në shtyllën nr. 1 “Demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë” me nënfushën “Decentralizimi dhe fuqizimi i qeverisjes vendore” dhe është në përmbushje të parashikimeve të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE) 2021-2023, Pjesa 2: Kriteri Politik & Pjesa 4 2.1 Demokracia dhe Shteti i së Drejtës, 2.1.3 Qeverisja; 2.1.4 Reforma në administratën publike; Kapitulli 11: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural; Kapitulli 14: Politikat e Transportit; Kapitulli 19: Politikat Sociale dhe Punësimi; Kapitulli 26: Arsimi dhe Kultura; Kapitulli 27: Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike; Kapitulli 32: Kontrolli Financiar.

Ky projektakt është planifikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Ministrisë së Brendshme për vitin 2022.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

SNDQV është vazhdim i angazhimit të Qeverisë Shqiptare me kohështirje 2023-2030, i cili targeton avancimin e mëtejshëm të agjendës së decentralizimit dhe konsolidimit të arritjeve ekzistuese, ashtu edhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Qeverisja vendore përfaqëson një nga themelet e qeverisjes së mirë, në shërbim të komunitetit dhe afër qytetarëve, duke përfaqësuar më së miri interesat/preferencat e tyre. Konsolidimi territorial shënon reformën më të rëndësishme administrative në vend, me riorganizimin e njësive të vetëqeverisjes vendore nga 373 njësi (308 komuna dhe 65 bashki) në 61. Reforma Administrative Territoriale (RAT) u shoqërua me decentralizim të një sërë funksionesh tek qeverisja vendore. Sot më shumë se kurdo, bashkitë kanë një numër të konsiderueshëm kompetencash për t’u shërbyer qytetarëve sipas nevojave dhe në mënyrë demokratike. Këto procese të rëndësishme eliminuan

fragmentarizimin e panevojshëm, rritën efikasitetin dhe efikasitetin në ofrimin e shërbimeve dhe përmirësuan dukshëm autonominë fiskale vendore. Kompetencat janë shoqëruar në mënyrë të vazhdueshme me mbështetje financiare nga ana e Qeverisë Qendrore, e cila e konsideron agjendën e decentralizimit shumë të rëndësishme në procesin e mirëqeverisjes dhe të integritetit evropian. Harmonizimi ligjor midis ligjit organik nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligjeve sektoriale kanë pasur gjithashtu vëmendje të shtuar gjatë periudhës pas RAT.

Decentralizimi gjithsesi nuk duhet konsideruar si një zgjidhje e menjëhershme e të gjithë sfidave në nivel vendor, por si një proces me zbatim holistik dhe persistent përsa i përket politikave vendore. Vlerësohet se ka ende nevojë për të intensifikuar bashkëpunimin ndërmjet qeverisë vendore dhe asaj qendrore, për të përputhur bazën ligjore (me akte ligjore dhe nënligjore) me funksionet, implementimin e funksioneve të reja dhe vazhdimin e punës për rritje të kapaciteteve të bashkive, shoqëruar me menaxhim më eficient të financave vendore dhe mirëqeverisje, me qëllim nxitjen e zhvillimit ekonomik vendor të qëndrueshëm. E rëndësishme është qasja nga poshtë lart, duke marrë në konsideratë perspektivën e pushtetit vendor në zbatimin e SKNDQV në tërësi dhe ushtrimin të funksioneve në veçanti.

Gjatë zbatimit të SKNDQV 2015-2020, u ndërmor Rishikimi Afatmesëm i Strategjisë, i cili theksoi rëndësinë e objektivave të SKNDQV për nevojat e qeverisjes vendore, duke vlerësuar Strategjinë aktuale si të rëndësishme dhe të vlefshme për NJVV, ndërsa vetë procesi i decentralizimit përfitoi nga një përditësim i Planit të Veprimit të strategjisë në 2020-2022. Rishikimi afatmesëm argumenton se *“strategjia mbetet e dobishme dhe e vlefshme për nevojat e të gjithë aktorëve të përfshirë, dhe ku është bërë një progres i rëndësishëm”* në agjendën e decentralizimit. Përtej këtij rishikimi akumulativ afatmesëm, SKNDQV është monitoruar në mënyrë të rregullt në vitet 2016, 2017, 2020, 2021. Progresi strategjik i parë në këndvështrimin administrativ, funksional dhe fiskal është vlerësuar në masën 67%.

Në këtë kuadër, SKNDQV synon zgjerimin, thellimin dhe shtimin e masave të parashikuara dhe të pazbatuara plotësisht, apo edhe të zbatuara por që kërkojnë mbështetje për qëndrueshmëri afatgjatë, sipas qëllimeve strategjike të përcaktuara që në SKNDQV 2015-2020.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti propozohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, sipas të cilit ndër të tjera përcaktohet se, *“Këshilli i Ministrave merr vendime për përcaktimin e drejtimeve kryesore të politikës shtetërore”*, vendimin nr. 604, datë 20.10.2021 të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”*.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk përafron në vetvete një akt të legjislacionit të Bashkimit Evropian, por do të shërbejë si instrument për adresimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian për përafrimin me *acquis communautaire* për fushën e rendit dhe sigurisë publike.

SNDQV lidhet me të PKIE 2022-2024, konkretisht me kriterin politik Pjesa 2: Kriteri Politik, 2.1.3 Qeverisja; 2.1.4 Reforma në administratën publike; Kapitulli 11: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural; Kapitulli 14: Politikat e Transportit; Kapitulli 19: Politikat Sociale dhe Punësimi; Kapitulli 26: Arsimi dhe Kultura; Kapitulli 27: Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike; Kapitulli 32: Kontrolli Financiar.

SNDQV lidhet me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, e miratuar me ligjin nr. 9590, datë 27.07.2006 *“Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare”*, përkatësisht me nenin 110 *“Zhvillimi rajonal dhe lokal”*, neni 111 *“Administrata publike”*.

Ky dokument politik lidhet me Objektivin 4 të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) i cili siguron arsim cilësor gjithëpërfshirës dhe të drejtë dhe nxitja e mundësive për mësim gjatë gjithë jetës për të gjithë me Objektivin 6: *“Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujësjellës-kanalizimeve për të gjithë”* dhe me Objektivin 16: *Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i mundësisë për drejtësi për të gjithë dhe*

ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënese dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Strategjia ka gjashtë qëllime strategjike, të cilat janë:

Qëllimi i parë i politikës synon të nxjerrë në pah funksionin e zhvillimit ekonomik vendor të NJVV-ve duke u fokusuar tek rivitalizimi i instrumenteve ndërvendore të bashkëpunimit si incentivimi i marrëveshjeve ndërbashkiake për të rritur ekonominë e shkallës, përfshirë këtu edhe qartësimin apo harmonizimin e kuadrit ligjor me qëllim ushtrimin e plotë të kompetencave ekzistuese lidhur me zhvillimin ekonomik vendor, shfrytëzimin eficient të burimeve/aseteve/kapitalit natyror në nivel vendor, përdorimin e kompetencave ekzistuese në funksion të zhvillimit ekonomik, lehtësimin e procesit të transferimit të pronave publike të NJVV-ve dhe vlerësimin e prerogativave vendore, rajonale dhe qendrore në fushën e zhvillimit vendor. Objektivat specifik të kësaj shtylle janë si më poshtë vijon:

- ✓ Objektivi specifik 1.1: Përmirësimi i planifikimit ekonomik strategjik dhe përdorimi i skemave dhe incentivave vendore për zhvillim ekonomik ndaj bizneseve dhe organizatave joqeveritare, duke përfshirë rishikim të kuadrit ligjor;
- ✓ Objektivi specifik 1.2: Menaxhimi i integruar i aseteve dhe burimeve natyrore vendore;
- ✓ Objektivi specifik 1.3: Vlerësim dhe përcaktimi i prerogativave vendore, rajonale dhe qendrore në zhvillimin vendor e rajonal
- ✓ Objektivi specifik 1.4: Forcimi i zhvillimit bujqësor dhe agro-përpunues
- ✓ Objektivi specifik 1.5: Mbështetja për fuqizimin e strukturave të turizmit dhe trashëgimisë kulturore.

Qëllimi i dytë i politikës synon që Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të ofrojnë shërbime efikente për qytetarët duke konsoliduar rolin e tyre të pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve të veta bazuar në standarde të mirëpërcaktuara dhe duke rritur ndjeshëm performancën e tyre. Ky qëllim synohet të arrihet nëpërmjet objektivave specifik:

- ✓ Konsolidim i rolit të NJVV në ushtrimin e funksioneve të tyre duke qartësuar mangësitë dhe mbivendosjet ligjore, institucionale dhe mekanizmat e financimit në marrëdhëniet ndërqeveritare.
- ✓ Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në nivel vendor, shoqëruar me rritje të kapaciteteve administrative vendore me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike;
- ✓ Përmirësim i efikasitetit të shërbimeve, në përputhje me standardet kombëtare e vendore.
- ✓ Përmirësimi i performancës së qeverisjes vendore bazuar mbi një sistem nxitës të performancës, që shërben si një mekanizëm dialogu dhe llogaridhënieje ndaj komuniteteve vendore.

Qëllimi i tretë i politikës synon digjitalizimin e shërbimeve vendore dhe përmirësimin e infrastrukturës së ofrimit të tyre. E-qeverisja është menduar si një mënyrë për të rritur efektivitetin administrativ, sikurse edhe sjell përfitime si promovimi i vlerave demokratike dhe përfshirja e qytetarëve (Bannister dhe Connolly, 2014; Bernhard, 2015). Digjitalizimi i lejon qeveritë të veprojnë me transparencë dhe efikasitet më të madh. Në epokën digjitale, përdorimi i teknologjisë së informacionit ka potencial për të përmirësuar cilësinë e shërbimit publik, si në nivel qendror, ashtu edhe atë vendor.

Në dekadën e fundit, Shqipëria ka investuar gjithnjë e më shumë në krijimin e një strukture dhe kulture solide të qeverisjes elektronike, me implikime të drejtpërdrejta në transformimin e kanaleve të ofrimit të shërbimeve publike. Qeveritë kanë treguar një angazhim të palëkundur për të avancuar drejt shërbimeve online. Si rezultat, e-Qeverisja është sot një realitet i prekshëm në Shqipëri. Portali i qeverisë online (e-Albania) tani ofron deri në 1,225 shërbime publike online, ose rreth 95% e tyre nga vetëm 14 shërbime të ofruara me fillimin e ndryshimit digjital rreth një dekadë më parë.

Pas shërbimeve elektronike të ofruara qëndron një arkitekturë komplekse, Platforma Qeveritare e Ndërveprueshmërisë, e cila është arkitektura bazë që mundëson ndërlidhjen e regjistrave elektronikë me njëri-tjetrin dhe shkëmbimin e të dhënave në kohë reale. Deri më sot janë 55 regjistra elektronikë, të cilët ndërveprojnë me njëri-tjetrin në kohë reale, duke bërë që 66% e formularëve për aplikime të ndryshme të plotësohen automatikisht në e-Albania, duke shkurtuar kohën e dhënies së dokumentacionit dhe duke thjeshtuar më tej procedurat.

Qëllimi i katërt i politikës synon rritja e nivelit të autonomisë financiare të pushtetit vendor, veçanërisht duke rritur nivelet e financimit të funksioneve vendore. Rritja e autonomisë fiskale është parashikuar të arrihet nëpërmjet (i) rritjes së të ardhurave vendore nga tatimi mbi pasurinë e paluajtshme, (ii) rritjes së pjesës së taksave të ndara, dhe (iii) gjenerimit të të ardhurave nga aktiviteti ekonomik i njësive të veteqeverisjes vendore nëpërmjet përdorimit më eficient të aseteve vendore. Ky qëllim synohet të arrihet nëpërmjet objektivave specifik:

- ✓ Objektivi specifik 1: Rritja e kapacitetit të të ardhurave vendore me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimeve cilësore dhe me standarde;
- ✓ Objektivi Specifik 2: Nivel i përmirësuar i parashikueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së transfertës ndërqeveritare dhe përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për financimin me transfertë për funksionet vendore apo projektet kapitale në sektorë strategjikë për njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- ✓ Objektivi Specifik 3: Rritja e kapacitetit të burimeve financiare vendore me qëllim financimin e projekteve kapitale lokale.
- ✓ Objektivi specifik 4: Forcimi i sistemeve në nivel vendor të menaxhimit të financave publike dhe të informacionit financiar.

Qëllimi i pestë i politikës synon përmirësimin e demokracisë vendore dhe avancimin e agjendës së integritetit evropian në nivel vendor është një ndër objektivat e një rëndësie të veçantë në këtë strategji, me synimin për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse të mirëqeverisjes në nivel vendor dhe forcim të demokracisë vendore, nxitje të politikave kundër korrupsionit dhe konsolidim i mëtejshëm i arritjeve mbi integritetin. Ky objektivi përfshin objektivat specifike si më poshtë vijon:

- ✓ Objektivi specifik 1: Forcimi i demokracisë vendore nëpërmjet sigurimit të një qasje gjithëpërfshirëse të mirëqeverisjes në nivel vendor.
- ✓ Objektivi specifik 2: Nxitja e politikave kundër korrupsionit në nivel vendor dhe konsolidimi i mëtejshëm i arritjeve mbi integritetin.
- ✓ Objektivi specifik 3: Avancim i agjendës së integritetit evropian në nivel vendor.

Qëllimi i gjashtë i politikës synon forcimin e kapaciteteve institucionale të strukturave qendrore dhe të dekoncentruara në mbështetje të qeverisjes vendore. Kjo shtyllë e strategjisë përfshin forcimin e kapaciteteve institucionale të një sërë strukturash në mbështetje të qeverisjes vendore si Ministria e Brendshme/Drejtoria për Çështjet Vendore, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Këshilli Konsultativ, Grupi Tematik i Decentralizimit, dhe Institucion i Prefektit.

Ky objektiv përfshin objektivat specifike si më poshtë vijon:

- ✓ Objektivi Specifik 1: Hartëzim i marrëdhënieve, roleve dhe detyrave të institucioneve qendrore dhe dekoncentruara në mbështetje të qeverisjes vendore.
- ✓ Objektivi Specifik 2: Forcimi i kapaciteteve të strukturave qendrore.
- ✓ Objektivi Specifik 3: Forcimi i kapaciteteve të strukturave të dekoncentruara.

Arritja e këtyre qëllimeve kërkon përpjekje të gjithanshme nga të gjitha ministratë e linjës dhe agjencive shtetërore përfshin edhe NJVV-së si institucione përgjegjëse ose/dhe kontribuese për një sërë masash, por edhe aktorë të tjerë në mbështetje të zbatimit të SNDQV janë edhe qarqet, shoqatat e qeverisjes vendore, partnerët e zhvillimit dhe organizatat joqeveritare. Kjo strategji mbulon periudhën 2023-2030, për t'i dhënë mundësinë agjendës së decentralizimit për ndërhyrje holistike dhe kuptim-plotë. Ndërsa plani i veprimit do të jetë 3-vjeçar, duke përfshirë aktivitete dhe masa afatshkurtra dhe me produkte të afërta në kohë.

Masat dhe ndërhyrjet që propozohen kanë karakter ligjor, institucional por edhe karakter specifik zbatimi për avancimin e mëtejshëm të decentralizimit dhe fuqizimin e qeverisjes vendore.

Disa tregues të përzgjedhur të nivelit strategjik në zbatim të SNDQV 2023-2030, janë si më poshtë:

- Numri i bashkive që financojnë shërbimet sociale përmes mekanizmit të Fondit Social;
- Numri i bashkive që ofrojnë shërbime sociale me bazë komunitare;

- Numri i përfituesve në skemat e miratuara të strehimit social që i përkasin grupeve në pozita të pafavorizuara;
- Numri i bashkive që trajtojnë mbetjet sipas standardeve;
- Punonjësit e policisë bashkiake të trajnuar në nivel vendor;
- Të ardhurat nga taksa e pasurisë së paluajtshme në raport me PBB (%);
- Buxheti i qeverisjes vendore në raport me PBB (%);
- Raporti i të ardhurave të veta vendore në raport me PBB (%);
- Numri i planeve të integritetit të hartuara në nivel vendor;
- Numri i akteve ligjore që adopotojnë direktivat e BE-se të shqyrtuara nga KK;
- Numri i projekteve të financuara nga BE në nivelin vendor.

Bashkëpunimi me shoqatat e qeverisjes vendore, partnerët e zhvillimit dhe organizatat joqeveritare, ka gjithashtu rëndësi themelore, pasi ndikojnë ndjeshëm në zbatimin e strategjisë dhe kanë një rol të rëndësishëm edhe në monitorimin e zbatimit të këtij Plani Veprimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen për zbatimin e këtij projektakti sipas fushave të politikave të përfshira në SNDQV 2023-2025, ku përcaktohen qartë, ministritë e linjës dhe institucionet në varësi të tyre që janë përgjegjëse për zbatimin e tij:

Konkretisht nga ministritë dhe institucionet e tyre janë Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Kulturës, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimet, Departamenti i Administratës Publike, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Institucione të tjera të ngarkuara janë Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit Agjencia Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga Ministria e Brendshme dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore. Draft SNDQV 2022-2030 është hartuar dhe koordinuar nga Ministria e Brendshme dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore me kontributin e Grupit Ndërinstitucional të Punës me përbërje në nivel Zëvendësministri/ Drejtor i Përgjithshëm dhe nëngrupeve Teknike të Punës, sipas tematikave/funksioneve të deleguara në nivel specialistësh dhe ekspertësh, të ngritura me urdhrin nr. 76, datë 22.04.2022 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore dhe Planin i Veprimit, 2023-2030”. Gjithashtu ky dokument është hartuar me mbështetjen e shoqatave vendore dhe të partnerëve të zhvillimit përmes një grupi ekspertësh, të cilët lehtësuan punën e GNT në përgatitjen e këtij dokumenti strategjik, që nga momenti i hartimit deri në përgatitjen e pasaportës së treguesve. Kontribute kanë dhënë gjatë procesit të konsultimit dhe aktorë të tjerë në nivel qendror dhe nivel të vetëqeverisjes vendore dhe partnerët e zhvillimit që punojnë me qeverisjen vendore.

Janë zhvilluar këto takime:

Data	Takimet e organizuara
25 Mars 2022	Mbledhja e Grupit Tematik të Decentralizimit për hartimin e strategjisë së Re të Decentralizimit, me pjesëmarrjen e partnerëve të zhvillimit dhe donatorëve, të cilët do të mbështesin me ekspertë dhe ekspertizë.
21 Prill 2022	Miratim i vizionit, konceptit dhe afateve kohore të SNDQV 2023-2030 nga Komiteti i Planifikimit Strategjik.
12-13 Qershor 2022	Takim konsultativ me SIGMA-OECD mbi metodologjinë e hartimit të SNDQV-së 2023-2030.

17 Qershor 2022	Konferenca hapëse mbi hartimin e Strategjisë 2023-2030 dhe Planit të Veprimit.
29 Qershor 2022	Takim me kryetarët e bashkive të qarkut Elbasan dhe Shoqatën për Autonomi Vendore.
28-29 Gusht 2022	Seminar mbi rekomandimet e disa funksioneve specifike të njësive të vetëqeverisjes vendore.
23 Shtator 2022	Takim konsultativ për hartimin e Strategjisë me stafet teknike të bashkive dhe të këshillave bashkiake.
29 Shtator 2022	Takim me Grupin Politik të Punës mbi hartimin e SNDQV-së dhe Planit të Veprimit.

Projektvendimi dhe relacioni shoqërues do të përcillen nëpërmjet sistemit e-aktet pranë:

- Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
- Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministrisë së Drejtësisë;
- Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministrisë së Kulturës;
- Ministrisë për Rininë dhe Fëmijët;
- Ministrisë për Standardet e Shërbimet.

Projektvendimi dhe relacioni shoqërues do të përcillen me shkresë zyrtare për mendim pranë:

- Departamentit të Administratës Publike;
- Agjencisë Kombëtare së Mbrojtjes Civile
- Shkollës Shqiptare të Administratës Publike;
- Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;
- Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit;

- Fondit Shqiptar të Zhvillimit;
- Agjencisë Kombëtare të Mjedisit;
- Agjencisë Kombëtare të Pyjeve;
- Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore;
- Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Kjo strategji financohet nga një sërë burimesh, Qeveria Shqiptare, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe Partnerë Zhvillimi. Në terma të kostimit, Strategjia vjen e shoqëruar me një Plan Veprimit 3 vjeçar (2023-2025) të kostuar sipas standardeve IPSIS dhe metodologjisë së OECD/SIGMA.

Duke qenë se, të gjithë objektivat specifike, përkatësisht 1-6, parashikojnë asistencë teknike, mbështetje të njësive të vetëqeverisjes vendore, studime, vlerësime ligjore dhe teknike të funksioneve të deleguara pushtetit vendor, i gjithë plani i veprimit shoqërohet me kostot indikative sipas zërave përkatëse, të cilat janë të mbështetura edhe në Programin Buxhetor Afatmesëm.

PROPOZUESI

MINISTRI

BLEDAR ÇUÇI